

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6508  
E mërkurë, 12 janar 2022  
çmimi 0.40 €

## Qeveria do të kujdeset për modernizimin e ushtrisë me pajisje dhe armatim

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

NËNKRYETARI I ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (OVLUÇK), NASIM HARADINAJ, KA DHËNË DËSHMINË E TIJ NË DHOMAT E SPECIALIZUARA NË HAGË

## HARADINAJ: SPECIALJA ËSHTË E PADREJTË, PO SULMON UÇK-në



Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, ka dhënë dëshminë në procesin që Gjykata Speciale është duke zhvilluar ndaj tij dhe Hysni Gucatit. Ai ka mohuar pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, duke thënë se kjo gjykatë është arbitrare dhe njëetnike. Duke iu përgjigjur pyetjeve të avokatit të tij, Haradinaj është shprehur për zbulimin e të gjitha krimeve. Sipas tij, Gjykata Speciale është duke e sulmuar UÇK-në

### AKTUALE



VDES PRESIDENTI I PARLAMENTIT TË BE-së, DAVID SASSOLI F. 2

KOSOVA BËHET ME OFICERE NDËRLIDHËSE NË DEPARTAMENTIN AMERIKAN TË SHTETIT F. 5

HOVENIERI TAKON KONJUFÇËN DHE KURTIN, VLERËSOHET BASHKËPUNIMI SHBA - KOSOVË F. 3

### EKONOMI



TRUSTI PËRFITON 227 MILIONË EURO PAS KTHIMIT NGA INVESTIMET PËR VITIN 2021 F. 8

NGA MBYLLJA, NË PUNË JASHTË ORARIT F. 8

### SPORT



MALISHEVA PËRFORCOHET ME DY MBROJTËS VETERANË F. 10

## Konfirmohen edhe 356 raste të reja me Covid

FAQE 3



## FAMILJA E SALI MUSTAFËS: CALIT PO I SHKELEN TË DREJTAT E NJERIUT NË HAGË

FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Vdes presidenti i Parlamentit të BE-së, David Sassoli

**BRUKSEL, 11 JANAR** - Presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli, ka vdekur në moshën 65-vjeçare, ka thënë zëdhënësi i tij, Roberto Cuillo. Sassoli ka vdekur më 11 janar në një spital në komunën Aviano të Italisë, ka thënë Cuillo. Më 10 janar Parlamenti i BE-së ka konfirmuar se politikani italian i qendrës së majtë është

shtrirë në një spital në Itali prej 26 dhjetorit. Përmes një deklarate, është thënë se "shtrirja në spital ka qenë e domosdoshme për shkak të komplikimeve serioze të nxitura nga mosfunksionimi i sistemit imunitar". Sassoli ka qenë anëtar i Parlamentit të BE-së që nga viti 2009.

Më 2019 ai është zgjedhur president i Parlamentit me bazë në Strasburg, pas propozimit të bërë nga Aleanca Progresive e Socialistëve dhe grupi i demokratëve. Mandati i tij do të përfundonte në fund të këtij muaji, dhe ai nuk pritej që të kandidonte për një mandat të dytë.



## Gjermania thotë se i duhen punëtorë të huaj

**BERLIN, 11 JANAR** - Me qëllim që ta shmangë mungesën e punëtorëve, në Gjermani duhet të ndodhë një migrim i shkallës së gjerë. Kështu ka deklaruar ministri i Ekonomisë, Robert Habeck, i cili argumentoi se mungesa e fuqisë punëtore

minon produktivitetin dhe vë në rrezik tranzicionin e suksesshëm të energjisë. "Ne tani kemi 300 000 vende të lira të punës dhe ne presim që ky numër të arrijë deri në një milion", ka pohuar ai të martën në një konferencë për medie. "Nëse nuk arrijmë ta

mbushim zbrazëtirën, ne do të kemi probleme reale të prodhimit", ka bërë me dije ai. Habeck ka thënë se trajnimet për punë do të ndihmonin shumë, por migrimi më i madh do të jetë thelbësor "për inxhinierët, zejtarët" dhe profesionet e tjera.

## Europoli urdhërohet t'i fshijë të dhënat që nuk lidhen me krime

**HAGË, 11 JANAR** - Agjencia e Bashkimit Evropian për Krim (Europol) është urdhëruar nga një institucion i BE-së për mbrojtjen e të dhënave, që t'i fshijë informacionet e lidhura me personat që dëshmohet se nuk kanë lidhje me krime. Mbikëqyrësi evropian për Mbrojtjen e të Dhënave tha më 10 janar se Europol është njoftuar me këtë vendim më 3 janar, pas një hetimi që kishte nisur në vitin 2019. Si pjesë e këtij hetimi, ky mbikëqyrës e kishte qortuar Europolin dy vjet më parë "për

ruajtjen e vazhdueshme" të të dhënave të shumta "që përbëjnë rrezik për të drejtat themelore të individëve". Po ashtu, u tha se Europol që atëherë ka ndërmarrë disa masa, por nuk ka plotësuar kërkesën që të vendosë një afat të përshtatshëm kohor për ruajtjen e të dhënave. "Kjo nënkupton që Europol po i mbante këto të dhëna më gjatë sesa ishte e nevojshme", tha mbikëqyrësi evropian për Mbrojtjen e të Dhënave. Ky institucion tha se vendosi një periudhë gjashtëmujore për

vlerësimin e grupeve të reja të të dhënave për të përcaktuar nëse ato të dhëna duhet të ruhen. "Një periudhë gjashtëmujore për analiza paraprake dhe filtrimin e grupeve të mëdha të të dhënave do t'i mundësonte Europolit që t'i përmbushë kërkesat për operacione të shteteve anëtare të BE-së që mbështeten në ndihmën teknike dhe analitike nga Europol, duke minimizuar rreziqet për të drejtat dhe liritë e njerëzve", tha Wojciech Wiewiorowski, mbikëqyrës në



institucionin për mbrojtjen e të dhënave. Mbikëqyrësi evropian për

Mbrojtjen e të Dhënave nuk tregoi se sa të dhëna aktualisht ruhen nga Europol.

## Zemra e një derri transplantohet me sukses te një njeri



**NYU-JORK, 11 JANAR** - Kirurgët amerikanë kanë transplantuar me sukses zemrën e një derri të modifikuar gjenetikisht në trupin e një njeriu. Ende nuk dihet nëse operimi do të ketë sukses afatgjatë, mirëpo mjekët e Qendrës Mjekësore të Universitetit Marillend kanë thënë më 10 janar se procedura ka treguar se zemra e një kafshe mund të mbijetojë në trupin e njeriut, pa refuzim të menjëhershëm. Operimi është kryer më 7 janar te një pacient që nuk ka mundur të kryejë transplantim

normal dhe ka qenë në prag të vdekjes. "Ose do të vdisja, ose do të bëja këtë transplantim. Dua të jetoj. E di që është kërkim në errësirë, mirëpo është mundësia ime e vetme", ka thënë 57-vjeçari David Bennett para operimit. Zemra ka qenë e një derri të cilit i janë ndryshuar gjenet për të eliminuar një gjen që prodhon një lloj sheqeri, i cili do të nxiste refuzim nga trupi i njeriut. Mjekët i kanë dhënë disa ilaçe shtesë edhe pacientit në mënyrë që ta ndalin sistemin imunitar nga reagimi ndaj organit.

Kompania bioteknologjike "Revivicor", e cila ka dhënë zemrën e derrit, ka ofruar edhe veshkën e një derri në tetor për ta kryer transplantimin e parë të veshkës së një kafshe te një njeri, ndonëse truri i pacientit ka qenë i vdekur. Operimi është kryer në Nju-Jork. Aktualisht ka kërkesë të madhe për transplantim të organeve, mirëpo ka pak të tilla në dispozicion, andaj kjo gjë ka shtyrë shkencëtarët që të kërkojnë për mënyra alternative.



# Hovenieri takon Konjufcën dhe Kurtin, vlerësohet bashkëpunimi ShBA - Kosovë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 JANAR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim ambasadorin e ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier. Me këtë rast, kryetari Konjufca i ka uruar mirëseardhje ambasadorit Hovenier dhe i ka dëshiruar suksese në detyrën e re.

Kreu i Kuvendit njëherësh ka vlerësuar lart miqësinë e palëkundur dhe partneritetin shembullor me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke vënë në pah se e ardhmja e Republikës së Kosovës është në BE, NATO dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare. Ai, po ashtu, ka falënderuar ambasadorin Hovenier për përkrahjen e vazhdueshme dhe për mbështetjen e gjithanshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhënë Kosovës, duke shprehur mirënjohje edhe për dhurimin e mbi gjysmë milioni të vaksinave "Pfizer" kundër koronavirusit.

Konjufca dhe ambasadori Hovenier kanë shprehur përkushtimin për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe, bashkërendimin e objektivave dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve tona.

Edhe kryeministri Albin Kurti i ka uruar mirëseardhje ambasadorit të ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey



Hovenier.

Kurti e ka njoftuar ambasadorin amerikan me reformat e ndërmarra nga qeveria pas zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021. "Zgjedhjet e shkurtit sollën legjitimitet demokratik dhe stabilitet politik në institucionet tona dhe aktualisht prijësit e tri institucioneve kryesore, Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria, gëzojnë mbi 50 për qind të besimit të qytetarëve. Ne e mbyllëm vitin

2021 me rritje ekonomike dyshifrore. Eksportet tona janë rritur 66 për qind, të hyrat buxhetore janë rritur 30 për qind, investimet e huaja direkte 53 për qind dhe kemi regjistruar 10 000 vende pune të reja në ekonomi vitin e kaluar", ka deklaruar kryeministri Kurti.

Duke biseduar për situatën rreth pandemisë, u theksua administrimi i mbi 1.67 milion dozave të vaksinave. Kurti ka

theksuar se Kosova ka vaksinuar 60 për qind të personave mbi 16 vjeç me dy doza dhe ka filluar dhënies e dozës së tretë dhe vaksinat përforcuese.

Kryeministri Kurti ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe presidentin Biden për dhurimin e mbi gjysmë milioni vaksinave "Pfizer". "Ne mirëpresim dhe jemi të inkurajuar nga fakti që presidenti Biden e ka shpallur korrupsionin një kërcënim të

sigurisë kombëtare për ShBA-në, por edhe për demokracinë në mbarë botën", ka deklaruar Kurti. Ai ka shprehur përkushtimin e tij dhe të institucioneve për ta çrrënjësuar korrupsionin dhe për të sjellë më shumë barazi dhe prosperitet për qytetarët.

Lidhur me dialogun me Serbinë, kryeministri Kurti ka theksuar se Qeveria e Kosovës ka qenë proaktive dhe konstruktive, duke paraqitur propozime se si të ecim përpara. Ai ka thënë se prioritet në dialog vazhdon të mbetet çështja e personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës në Kosovë dhe hapja e arkivave shtetërore dhe ushtarake të Serbisë.

Kryeministri Kurti dhe ambasadori Hovenier u pajtuan se njohja e ndërsjellë duhet të jetë në qendër të marrëveshjes së ardhshme, ligjërisht të obligueshme.

Ambasadori Hovenier e ka përgëzuar kryeministrin për përparimin e deritanishëm në Republikën e Kosovës dhe ka vlerësuar mbështetjen e ShBA-së, veçanërisht për zhvillim ekonomik, energji të qëndrueshme dhe arsim. Ai e ka vlerësuar menaxhimin e mirë dhe përgjigjen, siç ka thënë, mbresëlënëse kundër pandemisë. Një ditë më parë ambasadori i ri amerikan ka takuar edhe presidenten Vjosa Osmani dhe ministrin e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla.



## Konfirmohen 356 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 11 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të martën se në Kosovë janë regjistruar edhe 356 raste të reja me Covid-19. Rastet e reja dolën pas testimit të 7 258 mostrave. Sipas njoftimit të MSh-së, në 24 orët paraprake janë shëruar 53 pacientë,

ndërkaq raste aktive janë 2 083. Sa i përket vaksinimit, autoritetet shëndetësore kanë administruar edhe 4 232 doza të vaksinës kundër Covid-19. Që prej fillimit të fushatës së imunizimit, në Kosovë me dy doza të vaksinës janë imunizuar 791 547 persona.

Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat mbi moshën 12-vjeçare. Ndërkaq, personat mbi 18 vjeç, që janë vaksinuar me dy doza të vaksinës para tre muajsh, mund ta marrin dozën përforcuese apo dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19.







NËNKRYETARI I ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (OVLUÇK), NASIM HARADINAJ, KA DHËNË DËSHMINË E TIJ NË DHOMAT E SPECIALIZUARA NË HAGË

## Haradinaj: Specialja është e padrejtë, po sulmon UÇK-në

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, ka dhënë dëshminë në procesin që Gjykata Speciale është duke zhvilluar ndaj tij dhe Hysni Gucatit. Ai ka mohuar pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, duke thënë se kjo gjykatë është arbitrare dhe njëetnike. Duke iu përgjigjur pyetjeve të avokatit të tij, Haradinaj është shprehur për zbulimin e të gjitha krimeve. Sipas tij, Gjykata Speciale është duke e sulmuar UÇK-në

çka unë është dashur të jem transparent dhe ka qenë në interes të shërbimit publik. Pra, kjo është esenca jonë e kundërshtisë, se kjo gjykatë është monoetnike, selektive dhe arbitrare. Vazhdimisht ka krijuar precedent që ne të reagojmë”, ka deklaruar Haradinaj.

**Haradinaj tregon për dorëzimin e dokumenteve në zyrat e OVLUÇK-së**

Në dëshminë e tij, Nasim Haradinaj ka treguar për dorëzimin e pakove me dokumente që janë sjell në zyrat e OVLUÇK-së në vitin 2020. Ai ka thënë se pakoja e parë është sjell më 7 shtator të këtij viti, duke shtuar se ka qenë një ditë e zakonshme. Sipas tij, për ardhjen e paketës e kishte njoftuar recepcionistja Taibe Miftari. “Është ardhur e çakorduar. Ka qenë si të ishte e tmerruar. Na ka lajmëruar se ishte dikush dhe solli diçka. Na tregoi se ka sjellë një paketë dhe ka thënë se kjo është për atë që po fol në televizion. Kështu më duket që ka thënë”, ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se si e kanë kuptuar që këto dokumente janë nga ZPS-ja. “Në momentin që e kemi parë emrin e Vukçeviqit dhe shumë këtyre të tjerëve me rend, e kemi ditur se është diçka që iu përket materialeve të ZPS-së apo dikush i ka sjellë në emër të tyre...”, ka thënë ai.

Më pas Nasim Haradinaj ka

vazhduar rrëfimin për pakon e dytë të dokumenteve, duke shtuar se edhe në atë mëngjes ka qenë sërish në zyrë. “Por ndodhi, erdhi paketa. Edhe në paketën e dytë ka lënë porosi se do t’ju sjell përsëri”, ka thënë Haradinaj. Ai ka deklaruar se nuk e ka njohur as personin e parë e as personin e dytë që i kanë dorëzuar dokumentet. Sipas Haradinajt, në paketën e dytë kishte pasur korrespondenca dhe fletëfalënderime për bashkëpunimin e mirë që po bëjnë dhe po japin për zyrën e prokurorit. “S’e pashë asnjë falënderim të ndonjë organizate të shtetit tonë, prokurorisë apo diçka tjetër. Ndoshta ka mundur me qenë, sepse të gjitha faqet nuk i kam shikuar. Kam parë kërkesa që i kishin thirrur për t’ua siguruar vendet në Serbi. Aq sa kam parë, ishte tmer”, ka thënë Haradinaj.

**Haradinaj: Jam rritur në burgjet serbe**

Në seancën e parë të dëshmisë, Nasim Haradinaj fillimisht ka rrëfyer për jetën e tij, arrestimet dhe dënimet e torturat në burgjet e Serbisë. Ai ka deklaruar se deri në moshën 17-vjeçare ka qëndruar në Kosovë. “Po, jam rritur në Kosovë deri në moshën 17-vjeçare e gjysmë, ndërsa në pjesën tjetër të jetës jam rritur në burgjet serbe, kurse në vitet ’90 kam kaluar si klandestin në Suedi”, ka thënë

Haradinaj. Më pas Haradinaj ka thënë se në Suedi nuk ka qëndruar me dëshirë. “Edhe në Suedi në një mënyrë unë isha dhunshëm, pa dëshirën time. Unë nuk kisha dalë të kërkoj të mira ekonomike qysh kanë dalë shumë të tjerë, por kisha dalë prej dhune. Atje kam pasur pagë shumë të mirë, në vlerë prej pesë mijë eurosh neto, por dëshira dhe nostalgjia ime ishte që të kthehesha në Kosovë. Përkeheja në dy gjuhë”, ka thënë Haradinaj.

Nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj dhe kryetari i kësaj organizate, Hysni Gucati, akuzohen nga Gjykata Speciale për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. “Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se, së paku, midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si dhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjete sociale”, është thënë në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 11 JANAR** - Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, edhe të martën ka mohuar pretendimet e Dhomave të Specializuar ndaj tij. Në dhënien e dëshmisë në gjykimin që është duke u zhvilluar ndaj tij dhe kryetarit të OVLUÇK-së, Hysni Gucatit, Haradinaj ka thënë se Gjykata Speciale është njëetnike dhe e padrejtë. Ai është shprehur pro zbardhjes së të gjitha krimeve, duke shtuar se kjo nuk mund të bëhet në mënyrë selektive dhe nga një gjykatë e njëanshme siç është Specialja.

Derisa është përgjigjur në pyetjet e avokatit mbrojtës Toby Cadman, Haradinaj ka thënë se përmes UÇK-së prokuroria është duke e sulmuar Kosovën. “Edhe dokumentet sot i shoh të

përkthyer në tekst ‘Kosova Metohia’ që në Kosovë është e ndaluar. Kosova është shtet i pavarur, ndërsa në dokumentet e tyre përkthehet edhe në anglisht edhe në shqip fjala ‘Kosova Metohia’ që është e ndaluar me ligj. Kjo, nëse është gjykatë e Kosovës, ajo fjalë nuk duhet të jetë këtu hiç, por është këtu”, ka thënë Haradinaj. Para trupit gjykues Haradinaj ka thënë se Prokuroria Speciale e ka provokuar qëllimshëm Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Ai ka deklaruar se është arrestuar në mënyrë të paligjshme. Sipas Haradinajt, kjo gjykatë ka pasur mandat kur e ka arrestuar atë. “Mua nuk më brengos fati im personal dhe as i kurrkujt, nëse individualisht përgjigjem për diçka dhe duhet të përgjigjem nëse e kam bërë, por jo me këtë të na sulmoni diku më keq që pastaj me u ba pishman edhe bota pse na paska ndihmuar. Këtu është esenca për



# Familja e Salih Mustafës: Calit po i shkelen të drejtat e njeriut në Hagë

PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, njëherësh ish-ambasador, Nait Hasani, i shoqëruar nga bashkëshortja, Fatmirja dhe nga ish-i burgosuri Sadik Zeqiri, kanë vizituar familjen e Salih Mustafës - Calit. Ata janë pritur nga bashkëshortja e Calit, Vlora dhe fëmijët e tyre.

Qëllimi i vizitës së Nait Hasanit ishte që nga familja e Calit të informohet rreth gjendjes së Salih Mustafës në paraburgim dhe kujdesit që po tregon shteti për të gjithë të paraburgosurit në Hagë.

Salih Mustafa është në paraburgim në Hagë që nga viti 2020 dhe se ndaj tij është duke vazhduar gjykimi i ndarë nga të paraburgosurit e tjerë.

Bashkëshortja e Mustafës, Vlora, ka folur për vizitat që ka pasur në Hagë te Cali si dhe për perkujdesjen e shtetit të Kosovës. Ajo ka treguar për trajtimin që po i bëhet Calit brenda burgut të Hagës dhe për pengesat dhe vështirësitë e kontaktit me pjesëtarët e tjerë të familjes. "As babai i Calit nuk mund të flasë me djalin e tij për shkak të procedurave të cilat në këtë shekull do të quheshin si shkelje e të drejtave të njeriut", ka treguar ajo. Sipas Vlorës, familja ka vërejtje rreth procedurave të



vizitës dhe qëndrimit të familjes gjatë bisedës. "Nuk lejohet të ketë as privatësi gjatë bisedës për shkak të monitorimit të vazhdueshëm të tyre gjatë gjithë kohës së vizitës", ka bërë me dije ajo, duke shtuar se për këto shkelje i ka njoftuar edhe institucionet e Kosovës. "E kam njoftuar Avokatin e Popullit dhe kryetarin e Kuvendit të Kosovës por, si duket, nuk ka qenë disponimi i tyre që të punohet në

këtë drejtim", është shprehur bashkëshortja e Calit, Vlora. Ndërkaq ish-deputeti Nait Hasani ka premtuar se këto shqetësime të familjes, por edhe të familjarëve të tjerë, do t'i adresojë nëpër instanca të ndryshme që, sipas tij, të njoftohet opinioni i gjerë se Gjykata Speciale është politike dhe e njëanshme. "Pasi që edhe ne, unë dhe Sadik Zeqiri, ishim pjesë e burgjeve në të kaluarën

dhe e dimë rëndësinë e ndihmës që mund të japin institucionet, por që në kohën tonë ka qenë e pamundur ndihma e institucioneve. Tash situata është ndryshe. Kemi institucionet tona që flasin shqip, të cilat duhet të kanë kujdes më shumë për çlirimtarët tanë. Edhe nga këtu u bëj thirrje të gjitha institucioneve që të kujdesen sa më shumë për të paraburgosurit çlirimtarë të cilët po mbahen padrejtësisht në

Gjykatën e Hagës", është shprehur Nait Hasani, ish-ambasador i Kosovës në Shqipëri.

Hasani dhe Zeqiri këto ditë kanë vizituar edhe familjet e të paraburgosurve të tjerë.

Nga bashkëbisedimi që kanë pasur, kanë kuptuar se familjet e të gjithë të paraburgosurve në Hagë kanë vështirësi edhe sa iu përket udhëtimeve dhe pajisjeve me viza për në Hagë. Për çdo vizitë që familjarët e të paraburgosurve kanë në Hagë duhet të aplikojnë në ambasadën e caktuar për t'u pajisur me vizë. Familjeve u kërkohen një grumbull dokumentesh që të pajisen me vizë vetëm për aq ditë sa është e caktuar termimi i vizitës. Po ashtu, edhe për udhëtim kanë vështirësi për arsye se organet kompetente në Kosovë u kanë ofruar si mundësi udhëtimin me aeroplan në linjën Prishtinë-Vjenë-Amsterdam, ku familjarët e të paraburgosurve duhet të ndërrojnë aeroplan në dy vende, ndërsa mundësitë janë që të shkohet drejtpërdrejt pa asnjë vonesë në linja të tjera, duke i shmangur pritjet me orë të gjata. Sa iu përket çështjeve të tjera të udhëtimit dhe ndihmesës që po u ofrohen nga Shërbimi Konsullor i Kosovës në Hagë, familjet e të paraburgosurve janë falënderuese për kujdesin që po tregon ky institucion diplomatik.



## Kosova bëhet me oficere ndërlidhëse në Departamentin Amerikan të Shtetit

PRISHTINË, 11 JANAR - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka njoftuar se Merdiana Leci do të jetë zyrtarja ndërlidhëse e Kosovës në Departamentin Amerikan të Shtetit. Hovenier nëpërmjet një postimi në

"Twitter" ka thënë se programi i ri do ta fuqizojë bashkëpunimin ShBA - Kosovë. "Diskutim produktiv me ministren e Jashtme Gërvalla. Frymëzues takimi me Merdiana Lecin, diplomatja e parë e Kosovës që shërben

si zyrtare ndërlidhëse në Departamentin e Shtetit në Uashington. Ky program do ta fuqizojë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ShBA - Kosovë për prioritetet e përbashkëta të politikës së jashtme", ka shkruar Hovenier.





## 25 familje ndihmohen me nga katër metra kub dru dhe pajisje për ngrohje

Podujevë, 11 janar - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me përfaqësuesin e Shoqatës Humanitare "Tradita", përmes së cilës mundësohet mbështetje me lëndë drusore dhe pajisje për ngrohje për 25 familje në nevojë.

Kryetari Bulliqi u shpreh i lumtur që në këto ditë të ftohta dimri po u mundësohet ndihmë dhe mbështetje familjeve në nevojë. Përzgjedhja e familjeve përfituese do të bëhet nga një komision i përbashkët i shoqatës dhe komunës, ndërsa përparësi kanë familjet në

asistencë sociale, familjet me jetimë dhe me të sëmurë në familje.

Me projekte të tilla komuna dhe shoqata "Tradita" do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, ndërsa në këtë fazë po mbështeten 20 familje me nga katër metra dru dhe pesë familje me pajisje për ngrohje.



## Hamza inspektion gjendjen e rrugëve në rajonin e Shalës së Bajgorës

Mitrovicë, 11 JANAR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, i shoqëruar nga nënkryetari Arian Tahiri dhe drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Bahtir Maxhuni, kanë vizituar rajonin e Shalës së Bajgorës për ta inspektuar gjendjen e rrugëve pas reshjeve të borës.

Operatorët e kontraktuar kanë dalë në terren dhe po e kryejnë punën e tyre për largimin e borës dhe vendosjen e kripës që nga orët e hershme të mëngjesit, duke mundësuar kështu lëvizje të lirë të qytetarëve. Me këtë rast,

kryetari Hamza ka theksuar se në "qytet e sidomos në viset rurale ku kemi dendësi më të madhe të borës, intervenimet janë më të shpeshta, posaçërisht në rajonin e Shalës së Bajgorës, ku falë punës së kompanive të kontraktuara, shumica e rrugëve të cilat janë në kompetencë të komunës aktualisht janë të kalueshme". Ndërsa drejtori i DMSH-së, Bahtir Maxhuni, ka kërkuar nga kompanitë e kontraktuara që të jenë sa më aktive dhe të gatshme t'u dalin në ndihmë qytetarëve, sidomos në ato zona ku gjendja është më e vështirë.



## Hyseni paraqet punën njëmuore në qeverisje



Gjiçan, 11 janar - Kryetari i komunës së Gjiçanit, Alban Hyseni, ka paraqitur para medieve punën njëmuore. Ai ka bërë një përmbledhje të aktiviteteve të kësaj periudhe, që përfshin mbi 70 takime të ndryshme me qytetarë dhe mërgimtarë, me OJQ, shoqata dhe donatorë, me institucione të ndryshme të cilat bashkëpunojnë me pushtetin lokal, sikurse edhe mbi 20 vizita të ndryshme në kompani, ndërmarrje publike dhe vendpunishte.

Duke i nënvizuar disa prej angazhimeve më të rëndësishme, Hyseni ka thënë se me GIZ-in gjerman kanë diskutuar për projektin që ka të

bëjë me ambientin, pasi që komuna ka përfituar një grant prej 600 mijë eurosh. "Me USAID-in kemi diskutuar rreth projektit që ka të bëjë me monitorimin e komunës, në mënyrë që ky projekt të na shërbejë për rritjen e performacës, me OSBE-në kemi biseduar për rritjen e zbatueshmërisë së ligjit dhe respektimin e parimeve bazë ligjore juridike, sikurse kemi biseduar me policinë për çështje të ndryshme të sigurisë, për objektin e policisë, për funksionalizimin e kamerave të sigurisë dhe të tjera. Nga donatori austriak kemi pranuar një donacion prej 33 shtretërisht dhe 120 karroca elektrike.

Shtretërit janë vendosur në objektin e ri të QKMF-së dhe do të shfrytëzohen për qendrën Covid, nëse do të jetë e nevojshme", ka thënë Hyseni.

Hyseni ka përmendur edhe takimin me komunitetin sportiv, klube, sportistë e federata. "Jemi zotuar që si komunë së shpejti do t'i fillojmë punimet në palestrën sportive 'Bashkim Selishta', po ashtu kemi rishikuar projektin e stadiumit. Ritheksova se stadiumi është një nga prioritetet tona dhe presim ta përfundojmë brenda vitit 2022", ka thënë ai.

Hyseni ka folur edhe për angazhimet konkrete në shëndetësi, arsim, kulturë dhe shërbime publike.

## Inspektorati Komunal në Kamenicë mbyll një biznes në Roganë

KAMENICË, 11 JANAR - Inspektorati Komunal, i shoqëruar nga Policia e Kosovës, ka bërë inspektimin e subjektit afarist "Viva Fresh" Sh.PK në Rogaqicë dhe, pas inspektimit, është konstatuar se subjekti në fjalë ushtron veprimtarinë tregti me pakicë të artikujve ushqimorë pa u pajisur me pëlqim.

Andaj Inspektorati Komunal, duke u bazuar në Ligjin për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen

e Tregut, ka ndaluar përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë së këtij subjekti afarist deri në pajisje me pëlqim.


Lidhur me këtë, kryetari Kadri Rahimaj ka thënë se do të ofrojnë bashkëpunim për çdo investim në komunë, mirëpo për shkeljet e ligjit ka zero tolerancë. "Ligji mbi të gjitha. Në mungesë të lejes për ushtrimin e veprimtarisë,

Inspektorati Komunal e ka ndaluar ushtrimin e veprimtarisë së biznesit 'Viva Fresh Store' në Roganë. Ne mirëpresim çdo investim në komunën tonë dhe njëkohësisht do ta ofrojmë bashkëpunimin tonë maksimal për rritjen e punësimit dhe mirëqenies së qytetarëve. Mirëpo për shkeljet e ligjit, zero tolerancë", ka shkruar kryetari Rahimaj në rrjete sociale.





## Kurti vizitoi familjen e Rexhep Malës dhe të Nuhi Berishës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

GJILAN, 11 JANAR - Në 38-vjetorin e rënies, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar të martën familjen e dëshmorit

Rexhep Mala dhe atë të Nuhi Berishës në Gjilan. Në familjen Mala dhe Berisha kryeministri Kurti ka rikujtuar veprimtarinë patriotike dhe heroizmin e dy dëshmorëve të cilët u vranë duke luftuar në një

shtettrrethim të hekurt nga forcat serbe të policisë, në lagjen "Kodra e Trimave" në Prishtinë, më 11 janar të vitit 1984.

Kryeministri Kurti ka theksuar se veprimtaria e Rexhep Malës

dhe Nuhi Berishës frymëzon e inspiron secilin brez shqiptarësh, jo më pak se rënia e tyre heroike. "Liria kombëtare dhe drejtësia shoqërore u bënë bashkë te këta dy heronj të pavdekshëm, me jetën dhe

vdekjen e tyre", ka deklaruar ai. Lagjja ku luftuan këta dy heronj mori emrin Kodra e Trimave. "E sakrificat e tyre u bë flakë e janarit që vazhdon ta ndriçojë rrugën tonë", është shprehur kryeministri Kurti.

### PDK-ja: Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha frymëzuan breza të tërë në luftën për liri

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka përkujtuar heronjtë Rexhep Mala e Nuhi Berisha në 38-vjetorin e rënies së tyre. "Rexhep Mala e Nuhi Berisha ishin ndër

trimat patriotë që, nëpër dekadat e përpkjeve të popullit të Kosovës për çlirim, zemra u rrihte vetëm për Atdhe. Në historinë e lavdisë së Kosovës, që të dy zënë vend në

pedestal. Si intelektualë, veprimtarë e organizatorë të aktiviteteve kundër pushtuesit, Rexhep Mala e Nuhi Berisha frymëzuan breza të tërë të rinjve

e të rejave në luftën për liri. Në këtë ideal, në luftë frontale me policinë serbe, të dy ranë dëshmorë në mesnatën e 11 janarit të vitit 1984, për t'u shndërruar në flakën e

pashuar të janarit, e cila ndriçoi rrugën e secilit atdhetar deri në ditën e çlirimit. Lavdi jetës dhe veprës së heronjve tanë!", është thënë në deklaratën e PDK-së.

## Qeveria do të kujdeset për modernizimin e ushtrisë me pajisje dhe armatim

GJILAN, 11 JANAR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar regjimentin e parë të Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës në kazermën "NewBorn" në Gjilan. Në fjalimin para pjesëtarëve të regjimentit, kryeministri Kurti u shpreh i nderuar dhe krenar për vizitën dhe shtoi se nuk ka mënyrë më të mirë për ta filluar vitin e ri. Ai ka theksuar se këmbësoria, si degë më e vjetër e ushtrisë, dëshmon që teknologjia dhe pajisjet ushtarake, sado të sofistikuar dhe precize, nuk mund ta zëvendësojnë vrullin dhe fuqinë e luftarakut të zotë. Kjo, siç u tha ushtarëve kryeministri, e shton përgjegjësinë e udhëheqësve tuaj dhe secilit prej juve, që me moral të lartë dhe me përkushtim intensiv, si dhe me punë ekipore dhe stërvitje të rregullt, të



veproni bashkë, shumë bashkë, aq bashkë, sa që sikur një. "Në vitin që lamë pas FSK-ja tregoi profesionalizëm të lartë,

përkushtim në shërbim të paqes e sigurisë jo vetëm brenda kufijve të saj, por edhe jashtë, si dhe jo vetëm për qytetarët e saj, por

edhe të gjithë ata që kanë nevojë. Një ndër sukseset më të larta të vitit 2021 ishte pjesëmarrja në 'Defender Europe '21', ku treguat

gatishmërinë, profesionalizmin dhe ndërveprueshmërinë me ushtarakët e NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka deklaruar Kurti. Ai ka theksuar se ushtria e Kosovës është ushtri e disiplinuar, e trajnuar mirë dhe ushtri e sukseseve. "Ngritja e ushtrisë është detyrë e jona e përbashkët. Qeveria e Republikës së Kosovës e merr me shumë përkushtim modernizimin e ushtrisë si në pajisje dhe armatim, ashtu edhe kushtet e shërbimit si dhe ofrimin e mundësive, ku ju mund t'i tregoni shkathtësitë ushtarake. Arritja e qëllimeve tona shtetërore dhe kombëtare kërkon shumë punë, disiplinë dhe bashkëveprim. Ushtria këtë e kultivon më së shumti. Ju këtë e tregoni më së miri", ka thënë Kurti.

### Në vitin 2021 në Klinikën e Gjinekologjisë lindën 8 984 foshnja

PRISHTINË, 11 JANAR - Gjatë vitit 2021 në Klinikën e Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës

u lindën 8 984 foshnja. Prej këtyre, 202 janë binjakë, 16 trinjakë dhe 2 katërnjakë. Shërbimi Spitalor Klinik dhe

Universitar i Kosovës ka njoftuar se, sipas raportit të punës, 4 735 foshnja i përkasin gjinisë mashkullore, kurse 4 249

foshnja të tjera gjinisë femërore. Vlen të theksohet se 2 501 lindje janë kryer me operacion.





# Nga mbyllja, në punë jashtë orarit

PRISHTINË, 11 JANAR - Për më shumë se 20 vjet të funksionimit pronari i kompanisë "ArtHouse", Blin Zeqiri, asnjëherë nuk kishte menduar se do të vijë një kohë që do të mendonte për mbylljen e biznesit. Ai për "Radion Evropa e Lirë" thotë se në pranverën e vitit 2020, kur edhe shpërtheu pandemia e koronavirusit në Kosovë, iu vështirësua shumë puna. "Depo me mall plot, punë hiç. Besomë që kanë qenë çaste shumë të vështira. Dorëzimi ishte e vetmja gjë që na binte në mend", thotë ai.

Kompania e tij, që ka mbi 30 punëtorë, ofron shërbime të sektorit të teknologjisë informative. Zeqiri thotë se kanë mbi 13 mijë pajisje të lëshuara me qira e që janë printerë dhe fotokopje të ndryshme.

Klientë të kësaj kompanie janë kryesisht bankat dhe shumë institucione shtetërore. "Duke qenë që 'ArtHouse' projektet kryesore i ka me zyra, do të thotë me njerëz që punojnë në zyrë, për shkak se kemi numër të madh të pajisjeve të lëshuara me qira te klientët tanë, pandemia na rëndoi shumë si kompani. Për arsye se prej 13 mijë pajisjeve, vetëm 1 000 prej tyre kanë shtypur", tregon Zeqiri.

Duke pasur borxhe të shumta dhe këst të madh të kredisë, Zeqiri u detyrua të gjente një alternativë që ta shpëtonte kompaninë dhe të mos largonte asnjë punëtor nga puna.

Disa muaj pas fillimit të pandemisë, kompania e tij u fokusua më shumë në departamentin e digjitalizimit, duke skanuar mbi 30 milionë dokumente të ndryshme për klientët.

Ky sektor doli të ishte shpëtimtar për kompaninë e Blin Zeqirit, pasi në mars të vitit 2021, kur në Kosovë filloi procesi i vaksinimit



## Shumë biznese të mbyllura dhe mijëra punëtorë pa punë

Që nga fillimi i pandemisë në Kosovë janë mbyllur shumë biznese, por janë hapur edhe mijëra të tjera. Vetëm gjatë vitit 2021, sipas Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve (ARBK), janë hapur mbi 9 000 biznese të reja. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, tregon për "Radion Evropa e Lirë" se cilat lloje të bizneseve kanë pasur rritje gjatë pandemisë në Kosovë. "Janë

disa biznese specifike që janë pjesë e shërbimeve digjitale dhe shërbimeve nga distanca për tregjet e jashtme. Edhe pjesa e produkteve farmaceutike ka pasur rritje gjatë pandemisë dhe pjesa e shërbimeve shëndetësore", thotë Rukiqi. Rukiqi thotë se bizneset vazhdimisht janë ankuar për mospërkrashje nga qeveria. "Në përgjithësi janë biznese që nuk e kanë pasur një stabilitet

paraprak. Nuk është ndonjë sektor i veçantë i cili mund të them që ka pasur mbyllje të shumta të bizneseve, por individualisht shumë biznese edhe janë mbyllur si pasojë që nuk kanë mundur ta përballojnë këtë pandemi", thotë Rukiqi.

Për t'i përballuar pasojat e pandemisë, Qeveria e Kosovës ka miratuar Pakon e Ringjalljes Ekonomike në vlerë prej 420

milionë eurosh. Në kuadër të kësaj pakoje bizneset janë ndihmuar kohë pas kohe. Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, gjatë vitit 2021 janë shuar 1 330 biznese të cilat kishin të punësuar rreth 3 300 punëtorë.

Derisa gjatë vitit 2020, sipas të dhënave, janë shuar 1 346 biznese.

kundër koronavirusit, "ArtHouse" filloi të printonte kartelat e vaksinimit për qytetarët e Kosovës. "Secila vaksinë, doza e

parë, i ka pasur nga dy kartonë. Kështu që ka pasur vëllim shumë të madh të printimit me disa pajisje. Procesi ka shkuar shumë

mirë. Tash jemi duke e përmblytur, pasi doza e tretë nuk kërkon karton të vaksinimit. Tash jemi duke i tërhequr pajisjet",

thotë ai. Gjatë kohës së pandemisë Zeqiri thotë se kanë punuar nga 15 orë në ditë.

## Trusti përfiton 227 milionë euro pas kthimit nga investimet për vitin 2021



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 JANAR - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) ka njoftuar se ka përmblytur vitin 2021 me rezultat shumë të kënaqshëm nga investimet, me kthimin bruto që kapi shumë prej +227 milionë eurosh. "Kjo shifër nominale është më e larta prej themelimit të institucionit, ndërsa rritja e çmimit të njësisë për këtë vit ishte 10.65 për qind, krahasuar me rritjen prej +3.03-përqindësh për vitin 2020", thuhet në njoftimin për medie. Sipas njoftimit, thuhet se në total mjetet pensionale u rritën me 365 milionë euro këtë vit, duke shkuar në 2.35 miliardë

euro. "Në fund të 2021-s rreth 77 për qind e mjeteve nën menaxhim ishin të investuara në tregjet financiare ndërkombëtare, kurse pjesa tjetër në Kosovë - sipas kriterëve të përcaktuara me ligj. Investimet në tregjet financiare ndërkombëtare vazhdojnë të kontribuojnë me rreth 95 për qind në totalin e performancës investuese", thuhet në njoftim. Sikurse kërkohet në parimet e vendosura në Ligjin mbi Fondet Pensionale dhe bazuar në strategjinë investuese të FKPK-së, bordi drejtues përgjatë vitit 2021, i ndihmuar nga menaxhmenti dhe stafi profesional i FKPK-së, ka ndërmarrë mbi 40 vendime për alokime të ndryshme të mjeteve pensionale. "Duke

konsideruar se 2021-shi ishte vit i afektuar nga pandemia, luhatshmëria në tregjet financiare dhe lëvizjet e ndryshme makroekonomike, strategjia investuese e FKPK-së është adaptuar në baza të rregullta, duke angazhuar edhe fonde të reja për ta mbajtur likuiditetin, sigurinë dhe diversifikimin e portofolit. Pritjet janë që viti 2022 të ketë luhatshmëri të lartë për shkak të pandemisë, vonesave në zinxhirin furnizues, inflacionin, rritjen e kamatave nga bankat qendrore dhe faktorët e tjerë gjeostrategjikë. Rrjedhimisht bordi drejtues mbetet i përkushtuar që të veprojë sipas kushteve dhe lëvizjeve në tregjet financiare", thuhet më tej në njoftimin e Trustit.







**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Malisheva përforcohet me dy mbrojtës veteranë

Klubi i Malishevës ka regjistruar dy transferet e para për këtë afat kalimtar. Ai ka angazhuar mbrojtësit me përvojë, Labinot Ibrahimin dhe Fidan Gërbeshi. Në ditët e ardhshme pritet që ky klub t'i transferojë edhe Xhevdet Shabanin dhe Behar Maliqin. Synimi i Malishevës në pranverë mbetet siguri i mbijetesës në Superligë



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 11 JANAR** - Skuadra e Superligës së Kosovës në futboll, Malisheva është përforcuar me dy mbrojtës të dëshmuar, Labinot Ibrahimin dhe Fidan Gërbeshi. Klubi që drejtohet nga strategu Arsim Thaqi, synon mbetjen në Superligë dhe ka filluar fuqishëm të përforcohet. "Labi është një lojtar mjaft i gjithanshëm. Kryesisht luan si qendër mbrojtës, e po ashtu luan edhe si mbrojtës krahu. Shquhet për aftësitë e shkëlqyeshme në krosime, hap dhe energji. Për shkak të gjatësisë, pozicionimit dhe karakteristikave të tij fizike, Labi gjithashtu është

shumë efektiv në ajër. Ka pasur një karrierë mjaft të bujshme në futbollin kosovar dhe atë të Shqipërisë. Një përvojë e jashtëzakonshme edhe në futbollin evropian, në Ligën e Kampioneve dhe Evropë Ligë. Ka filluar me FC Prishtinën pastaj ka luajtur për Partizanin e Tiranës, është rikthyer përsëri në FC Prishtinë. Sezonin e fundit luajti në FC Arbëria. Karriera e tij e deritashme është impesive", ka njoftuar skuadra e Malishevës. Ibrahimin ka zhvilluar 46 në Superligën e Kosovës dhe është paraqitur për Prishtinën, Ulpianën dhe Arbërinë, kurse ka qenë pjesë edhe e Kategorisë Superiore të Shqipërisë. Ai është

zhvilluar 153 ndeshje, derisa 9 ndeshje ishte pjesë në Ligën e Evropës dhe Ligën e Kampioneve në 6 ndeshje. Marrëveshja e arritur mes Malishevës dhe Labinot Ibrahimit është deri në fund të kampionatit. Mbrojtësi tjetër që e ka përforcuar skuadrën e Malishevës është Fidan Gërbeshi, i cili ishte pjesë e Feronikelit dhe Dritës. Fidan Gërbeshi, i cili ka një karrierë të pasur futbollistike në Kosovë. Ai ka realizuar në elitë plotësisht 132 ndeshje, kurse ka luajtur edhe në parakualifikuese të Ligës së

Kampionëve dhe Ligës së Evropës. "Marrëveshja me Fidanin për sezonin 2021/2022, i shton kualitetin klubit tonë dhe e bën FC Malishevën një konkurrent serioz në Superligë. Kryesisht luan si qendër mbrojtës. Një qendër mbrojtës i kompletuar, i qëndrueshëm dhe punëtor. Karrierën e tij si futbollist e filloi me Ka filluar me FC Ulpianën, pastaj luajti për FC Dritën, Feronikelin dhe së fundmi në FC Arbëria. Fidanin ka pasur një karrierë të bujshme dhe një përvojë mbresëlënëse si në

futbollin kosovar po ashtu edhe evropian", thuhet në njoftimin e Malishevës. Kjo skuadër gjatë ditëve në vijim pritet të transferojë edhe dy futbollistë të dëshmuar në futbollin kosovar, Behar Maliqin dhe Xhevdet Shabanin. Mesfushori Maliqi sezonin vjeshtor luajti për skuadrën e Feronikelit, kurse Shabani për Prishtinën. Klubi nga Malisheva sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e shtatë me 19 pikë të grumbulluara, ku nga 18 ndeshje ka regjistruar pesë fitore, katër barazime dhe nëntë humbje.

## Stinori pranveror fillon me derbin Trepça - Ylli

**PRISHTINË, 11 JANAR** - Në mesjavë zhvillohet xhiroja e 15-të e Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll apo e para për stinorin pranveror që pritet të jetë shumë interesante. Derbi do të zhvillohet në mes të Trepçës dhe Golden Eagle Yllit, dy skuadra që kanë grumbulluar nga dhjetë fitore dhe katër humbje. Të dyja skuadrat kanë ambicie të mëdha në këtë edicion dhe pritet një sfidë shumë interesante në "Minatori". Në

përballet e këtij edicioni secila skuadër ka nga një fitore ndaj tjetrës. Të enjten në kryeqytet Drita ndeshet me Sigal Prishtinën. Gjilanasit janë ende pa fitore në elitë me 14 humbje, kurse prishtinasit kanë shtatë fitore dhe shtatë humbje. Peja - Bashkimi është sfida e rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës. Në këtë edicion pejanët kanë nëntë fitore dhe pesë humbje, kurse prizrenasit tetë fitore dhe gjashtë humbje.

**SUPERLIGA - JAVA 15**

**Të mërkurën takohen:**  
19:00 Trepça - Golden Eagle Ylli

**Të enjten takohen:**  
Drita - Sigal Prishtina  
Peja - Bashkimi  
Prizreni 16 - Rahoveci (rezultati nga Liga Unike)

Prizreni 16 - Rahoveci, rezultati do të zhvillohet nga Liga Unike.



## Afati kalimtar, deri më 15 janar



**PRISHTINË, 11 JANAR** - Federata e Hendbollit e Kosovës ka njoftuar se afati kalimtar është i hapur deri më 15 janar. Sipas FHK-së, pritet të ketë lëvizje të hendbollistëve dhe

hendbollistëve nga një skuadër në tjetrën. "Më 7 janar është hapur afati kalimtar për hendbollistë dhe hendbollistë. Afati kalimtar është i hapur deri më 15 janar, ndërsa

pritet të ketë lëvizje të lojtarëve. Janë disa skuadra që kanë paralajmëruar angazhimin e lojtarëve të rinj për pjesën e dytë të kampionatit. Pritet garë e fortë si të

hendbollistët ashtu edhe të hendbollistët dhe shumë prej skuadrave pritet ta shfrytëzojnë afatin kalimtar të janarit", thuhet në njoftimin e FHK-së.

## Shqipëria në mars do të përballet me Gjeorgjinë

Tiranë, 11 janar - Zyrtarizohet edhe miqësorja e dytë e Shqipërisë në muajin mars. Kombëtarja shqiptare do të përballet me Gjeorgjinë më 29 mars në atë që do të jetë ndeshja e 14-t mes dy vendeve. Pas arritjes së pajtimit me Spanjën për miqësoren e 26 marsit, Federata Shqiptare e

Futbollit ka arritur një marrëveshje me Federatën Gjeorgjiane për të luajtur këtë ndeshje. Departamenti i Komunikimit në FSHF bën me dije se është rënë dakord që ndeshja të luhet në Shqipëri, ndërkohë që stadiumi dhe ora e sfidës mbeten ende për t'u

përcaktuar. Shqipëria dhe Gjeorgjia janë përballuar 13 herë në të kaluarin me një bilanc prej tri fitoresh për kuqezinjët, 3 barazime dhe 7 fitore për gjeorgjianët. Nga këto 9 ndeshje kanë qenë të vlefshme për eliminatorë të Evropianit e të Botërorit dhe 4 kanë qenë miqësore. Dueli i

parë është luajtur në Shqipëri më 14 dhjetor 1994 dhe ishte i vlefshëm për eliminatorë të Evropianit 1996. Ajo sfidë u fitua nga Gjeorgjia me rezultatin 1-0. Takimi i fundit mes Shqipërisë dhe Gjeorgjisë ka qenë miqësorja e 16 nëntorit



2015 që u luajt në stadiumin "Qemal Stafa" dhe u mbyll në barazim 2-2.



## Sonte Kosova përballet me Turqinë, përzgjedhësi Qerimi paralajmëron paraqitje të mirë

**PRISHTINË, 11 JANAR** - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll është kthyer në Prishtinë pas ndeshjes me Greqinë në udhëtim. Ndeshja e ardhshme e kualifikimeve për Botëror zhvillohet të mërkurën në Prishtinë.

“Dardanët” përballet me Turqinë (19:15). Për gjendjen në përfaqësuese, përzgjedhësi Bujar Qerimi ka dhënë një deklaratë për faqen zyrtare të FHK-së. “Ndeshja me Turqinë është e rëndësishme ashtu si ndeshjet e deritashme. Do të

përpiqemi të përgatitemi sa më mirë për ndeshjen e së mërkurës. Për shkak të një lëndimi në ndeshjen me Greqinë, na mungon Egzon Gjuka. Shpresojmë që ai të jetë gati për ndeshjen e fundjavës ndaj Belgjikës.

Ndërkohë nuk llogaris në Deniz Terziqin. Ai është i pezulluar për sjellje jokorrekte ndaj përfaqësueses dhe bashkëlojtarëve. Organet kompetente të Federatës marrin vendime tutje”, ka deklaruar Qerimi.



## Inzaghi: Nuk ka favoritë mes Interit dhe Juventusit

**MILANO, 11 JANAR** - Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, beson se si “Nerazzurët” ashtu edhe Juventusit kanë evoluar që nga hera e fundit që u takuan dhe këmbëngul se nuk ka favorit në finalen e Superkupës së sotme. Ndeshja në mes të fituesve të Serisë A të sezonit të kaluar dhe Kupës së Italisë fillon të mërkurën në orën 21:00 në “Stadio Giuseppe Meazza”. “Ne do të kemi nevojë për një paraqitje agresive dhe të vendosur. Jemi të vetëdijshëm se do të ketë momente ku Juve do të na krijojë telashe. Në gusht ata dukeshin favoritë për Scudetton, me Interin dhe klubet e tjera në garë. Por, fusha ka rëndësi. Tani jemi në krye, por gara do të jetë e hapur deri në fund”, ka deklaruar Inzaghi. “Juventusit ka një ekip konkurrues, Bonucci dhe Chiellini do të luajnë dhe dua t’i uroj fat Federico Chiesas. Unë nuk e njoh personalisht djalin, por kam luajtur me babanë e tij te Lazio. Federico është një trashëgimi për futbollin italian”, ka deklaruar Inzaghi. Interi barazoi 1-1 kundër Juventusit në tetor, me bardhezinjtë që shënuan golin e barazimit me një penallti të konvertuar në gol nga Paulo Dybala. “Ne menduam se e



kishim fituar atë ndeshje, pastaj ishte ajo penallti. Megjithatë, ishte shumë muaj më parë dhe të dyja skuadrat kanë evoluar që atëherë. Nuk ishte një ndeshje e bukur për të dyja skuadrat që nuk arritën standardet e tyre. Ne kemi një seancë stërvitore sot, luajtëm të dielën mbrëma dhe të gjithë ndihen mirë, përfshirë Edin Dzekon dhe Joaquin Corraan”, ka shtuar Inzaghi. “Të katër sulmuesit janë në formë, dy do të nisin dhe dy do të shkojnë në bankinë. Të kesh shumë opsione nuk ka qenë kurrë problem. Është një finale dhe nuk ka favorit në këto ndeshje.

Juventusit është i pamposhtur në tetë ndeshjet e fundit dhe ata bënë diçka të jashtëzakonshme të dielën”, ka pohuar ai. “Ata janë mësuar të luajnë në finale, kanë lojtarë me përvojë, por ne jemi në një moment të mirë”, ka përfunduar Inzaghi. Interi është lider në tabelën e Serisë A dhe ka fituar tetë ndeshjet e fundit radhazi në Serinë A. Ata kanë sulmin më të mirë në Serinë A me 51 gola të shënuara në 21 ndeshje dhe mbrojtjen e dytë më të mirë në ligë. Ata kanë pësuar 16 gola deri më tani, një më shumë se Napoli i Luciano Spalletit.

### SHKURT

#### Muriqi, mes Hullit dhe Leedsit

Sulmuesi i Lazios, Vedat Muriqi, mund të transferohet në Premierë Ligë, pasi për të janë të interesuara dy klube angleze. Qëndërsulmuesi i kushtoi 20 milionë euro Lazios për ta transferuar nga Fenerbahçe në shtator 2020, por ka pasur shumë pak ndikim në fanellën e Biancocelestit. Repreruesi nga Kosova bëri vetëm 48 paraqitje zyrtare për klubin, duke shënuar dy gola dhe duke dhënë dy asistime. Sipas “TuttoMercatoWeb”, Hull City kishte bërë një afrim për Muriqin, por tani ka kaluar në objektiva të tjerë. Ka një interesim të fortë nga Leeds Unitedi, i cili ka shënuar vetëm 21 gola këtë sezon dhe ndodhet në vendin e 16. Problemi është se Lazio duhet të shesë para se të mund të sjellë një zëvendësues dhe Leeds duket i prirë ta marrë Muriqin vetëm në huazim.

#### Futbollisti Çalik humbi jetën pas një aksidenti me makinë

Ahmet Çalik, mbrojtës i skuadrës turke i Super Lig Konyaspor, humbi jetën në një aksident automobilistik mëngjesin e së martës. Mbrojtësi 27-vjeçar humbi jetën pasi raportohet se humbi kontrollin e makinës së tij pranë Golbasi, në kryeqytetin Ankara. Ai ka luajtur në total 225 ndeshje si profesionist, ku ka realizuar tetë gola dhe tri asistime.

#### PSG-ja rikthen interesimin për Ronaldon

Cristiano Ronaldo pritet të largohet nga Manchester Unitedi. Ylli portugez ka pasur përplasjet e para me trajnerin Ralf Rangnick, i cili nuk po arrin ta këndellë ekipin. Në anën tjetër, sipas medieve në Francë, Paris Saint-Germain e ka rikthyer interesimin për Cristiano Ronaldon. Cristiano Ronaldo u rikthye në “Old Trafford”, por duket se nuk është i kënaqur dhe largimi mund të ndodhë edhe në këtë afat kalimtar. Interesim për portugezin ka shfaqur edhe skuadra e Barcelonës.

#### Isco nuk largohet nga Reali

Isco nuk dëshiron të largohet në janar nga Real Madridi. Lojtari nuk ka shumë minuta me Carlo Ancelottin, por nuk dëshiron të ndërrojë skuadër në janar sipas “Marca”-s. Për 29-vjeçarin kanë shprehur interesim shumë klube, edhe Fiorentina, por dëshiron të qëndrojë deri në qershor në “Santiago Bernabeu”. Ai beson se do të ketë shanse më të mira për të lëvizur te një klub më i madh gjatë verës, pasi pavarësisht që po luan pak më shumë së fundmi në Madrid, ka përfunduar aventura e tij me fanellën e “Los Blancos”.

## Mbrëmje zhgënjyese për pretendentët në NBA

**BOSTON, 11 JANAR** - Ekipi kampion i Milwaukee është mundur 103-99 nga Charlotte, ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Për



vendasit u dallua Rozier me 27 pikë, duke i bërë të pavlefshme 53 pikët e dyshes Middleton-

Antetokounmpo. Humbet edhe skuadra e Utah Jazzit, që u mund 126-116 nga Detroiti. Bey dhe Cunningham realizuan nga 29 pikë secili për Pistonsin, ndërsa 31 pikët e Mitchellit për Jazzin mbetën për statistikë. Mbrëmje zhgënjyese edhe për Brooklynin, që u mund 114-108 nga Portlandi. Duranti realizoi 28 pikë e 10 rebounde, por që s’mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për Portlandin të gjithë titullarët realizuan mbi 13 pikë.

### REZULTATET

Charlotte - Milwaukee	103-99
Detroit - Utah Jazz	126-116
Boston - Indiana	101-98
New York - San Antonio	111-96
Houston - Philadelphia	91-111
Portland - Brooklyn	114-108
Sacramento - Cleveland	108-109

## Qeveria shtyn vendimin për Djokoviçin, nisin hetimet për deklaratë të rreme

Ende nuk ka ardhur një vendim i qeverisë australiane në lidhje me tenistin serb Novak Djokoviç, nëse numri një në botë do të luajë në Australian Open apo jo. Djokoviç fitoi dje betejën në gjykatë, që i dha të drejtë të

luajë në grand slam që nis më 17 janar, edhe pse i pavaksinuar. Tenisti ka nisur menjëherë stërvitjen dhe po përgatitet për Australian Open, ku është kampion në fuqi. Gjithsesi, Ministria e Emigracionit ka apeluar

vendimin dhe ka fjalën e fundit, teksa mund ta anulojë lejen e qëndrimit dhe të kthejë mbrapsht tenistin në vendlindje. Vendimi i qeverisë ishte planifikuar për sot, por mësohet se është shtyrë për të mërkurën. Nga ana tjetër,

mediet australiane bëjnë me dije se Djokoviç po hetohet për deklaratë të rreme. Në aeroport, i pyetur nëse ka lëvizur në vende të tjera teksa ka qenë i infektuar, tenisti ka thënë jo. Ndërkohë që, pas infektimit me Covid-19 më 16

dhjetor, ai ka qenë i pranishëm në disa ngjarje dhe nuk ka kryer karantinën e detyruar. Për pasojë, ai po hetohet për deklaratë të rreme në kufi. Djokoviç qëndroi për stërvitje në Spanjë, nga ku u nis më pas për Australi.





# Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

## RESTAURANT

---


# SWISS

## TAVERNA

---


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



# Lume's Details

## Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Nazmije Zeqiri B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 71252213 nr. Unik identifikues: 811266841 si dhe certifikatën e numrit fiskal: 601594212.
- ▶ Blendi Xhavit Hasi, shpall të pavlefshme Diplomën e Bachelorit të Kolegjit AAB, drejtimi Marketing dhe Administrim Biznesi.
- ▶ Gentiana Gashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Ferdi Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Xhevat Berisha " Prizren.
- ▶ Gentrin Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " 17 Shkurti " Hatmaxhe.
- ▶ Jetmir Rizanaj shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.
- ▶ Ardit Emini shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Elmi Destani shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu " Dy dëshmorët " Pirane .
- ▶ Luan Ramadani shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Arjeta Thaqi Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të Gjmnazit " Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Liridona Markaj Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e SH.M.L.T. "Nexhmedin Nixha" Arkitekturë.
- ▶ Ferdinand Markaj Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e SH.M.L.T. "Nexhmedin Nixha" Arkitekturë.
- ▶ "Gashi Y" SHPK shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me Nrb: 811466045
- ▶ Bujar Sejdiu shpalle te pavlefshme diplomën e Shmlt "Arkitekt Sinani"
- ▶ Besim Musliu shpalle te pavlefshme diplomën e Shmlt "Anton Ceta"
- ▶ "Walo Group" Shpk shpall te pavlefshme certifikatën e Biznesit me nrb: 810183864
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

